



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1228/ 10 Prot.

Datë 03 .06.2026

V E N D I M
Nr. 747/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.592/2026, datë 06.05.2026 për procedurën e prokurimit, prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-79449-03-18-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi”. me fond limit 2,489,920.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01-04-2026 nga autoriteti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare.

Ankimues: Operatori ekonomik “Atlantik 3” Shpk, me Nipt *NIPT: K22218003V, Adresë: Autostrada Tianë-Durrës, km 10, Rruga Dytësore Vorë Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himarë, *Adresa: Pranë Stadiumit Himarë.*

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Besim Kamberi” P.F, *me Nipt L42103023G, Adresa: Rr. Rruga e Qelqit , Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 - Kashar 1001 , Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 06.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. **592/2026**, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Atlantik 3” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-79449-03-18-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi”. me fond limit 2,489,920.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01-04-2026 nga autoriteti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare.*
- 2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik sipas konstatimeve të këtij vendimi.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftoj për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Atlantik 3 ” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 256/21prot., datë 12.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1228/7 prot., date 18.05.2026, autoriteti kontraktor, *Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare.*, njofton se ka bërë rivlersimin dhe ka pasqyruar ndryshimet përkatëse për procedurën objekt ankimi, si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 256/21prot., datë 12.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1228/7 prot., date 18.05.2026, autoriteti kontraktor, *Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare*, njofton se ka bërë rivlersimin dhe ka pasqyruar ndryshimet përkatëse për procedurën objekt ankimi, si dhe

gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurën objekt ankimi.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit për rivlersimin e ofertave të paraqitura si dhe referuar shkresës 256/21prot., datë 12.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1228/7 prot., date 18.05.2026, autoriteti kontraktor, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor *Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare*, ka zbatuar vendimin Nr. 592/2026, datë 06.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-79449-03-18-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi”. me fond limit 2,489,920.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01-04-2026 nga autoriteti kontraktor *Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare*.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-79449-03-18-2026, me objekt “Blerje materiale pastrimi”. me fond limit 2,489,920.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 01-04-2026 nga autoriteti kontraktor *Ndermarrja e Sherbimeve Publike Himare*
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro